

Nr. 2 Regj.**Durrës, më 13. 01. 2025****Lënda:** Në përgjigje të kërkesës suaj.**Emër MBIEMËR****Adresa**

Në kuadër të implementimit të Ligjit Nr. 119/ 2014 “Për të drejtën e informimit” (i ndryshime), si dhe në referencë të kërkesës suaj, datë 09.01.2025, me objekt “Ecuria e punimeve e projektit të rehalbilitimit të linjës hekurudhore Durrës-Tiranë-Rinas”, e regjistruar në regjistrin e “Kërkesë/Ankesë/Përgjigje” në përputhje me nenin 8 të ligjit të sipërcituar me Nr. 2, ju informojmë për si vijon:

1- Sa përqind e punimeve kanë përfunduar në hekurudhën, Tiranë-Durrës-Rinas?

Për projektin “Rehabilitimi i Linjës Hekurudhore Durrës Tiranë dhe ndërtimi i Linjës së re Hekurudhore në drejtim të Aeroportit Ndërkombëtar të Rinasit (TIA) kanë përfunduar 80 % e punimeve ndërtimore.

2- Kur do të vendosen në funksion stacionet dhe kur nis udhëtimi i qytetarëve?

Kontrata e Zbatimit për Ndërtimin e Stacioneve Hekurudhore është një kontratë e re e cila pritet të nënshkruhet brenda 3 muajve të parë të vitit 2025. Për çështjen e operimit të trenave do të kontraktohet një konsulent i huaj i cili do të bëjë studimin përkatës dhe parashikohet të fillojë operimi brenda vitit 2026.

3- Stacioni fundor në Tiranë ku do të jetë? A do të ketë një stacion tjetër në qendër të qytetit? Cfarë projekti ka për këtë?

Projekti “Zgjatimi 4 Km nga Terminali Publik Tiranë (PTT) deri në Qendër të Tiranës (Tirana City Center TCC), është një projekt i ri, i ndryshëm nga projekti ekzistues. HSH është duke finalizuar me BERZH çështjen e financimit brenda 6 muajve të parë të Vitit 2025. Më tej do të vijohet me investimin për celjen e gareve ndërkombëtare. Stacioni fundor në Tiranë do të jetë në Bulevardin e Ri të Tiranës (pranë ish-stacionit të Trenit).

**Autoriteti publik “Hekurudha Shqiptare” Sh.A, angazhohet në garantimin e të drejtës së informimit, si garanci kushetuese dhe vepron në mbështetje të ligjit Ligjit Nr. 119/ 2014 “Për të Drejtën e informimit” dhe trajton kërkesën tuaj në përputhje me Ligjin nr. 9887 “Për mbrojtjen e të dhënave personale”.*

Me konsideratë!

KOORDINATORI I TË DREJTËS SË INFORMIMIT**Domeniko SINJARI**